



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No. <u>308/2021</u>
Nr./forr. str./Nr.pg. <u>08/03/21</u>
Data/Datum/Date:



PRISHTINE-PRIŠTINA-PRISTINA
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ex officio

Rasti nr. 49/2021

në lidhje me

të drejtat e nënave (prindërve) vetushqyese në Kosovë lidhur me njohjen e pushimit vjetor edhe për dy ditë punë për prindin vetushqyes, i cili i takon sipas Ligjit nr.03/L-212 të Punës i Republikës së Kosovës

Drejtuar:

Z. Skender Reçica, ministër në detyrë i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Z. Ekrem Kastrati, kryeinspektor i Inspektoratit të Punës

Prishtinë, më 8 mars 2021

I. QËLLIMI I RAPORTIT

1. Ky rapport ka për qëllim ta trajtojë çështjen e mosnjohjes së pushimit vjetor edhe për dy ditë punë shtesë për prindër vetushqyes, në përputhje me nenit 32 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës i Republikës së Kosovës.

II. KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

2. Në pajtim me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), Avokati i Popullit: “*Mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*” Në pajtim me këtë dhe me paragrafin 3 të këtij nenit: “*Çdo organ, institucion apo autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj.*”

3. Më tutje, Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit (më tej: Ligji për Avokatin e Popullit) në nenin 16, paragrafi 1, përcakton se i njëjti ka: “*Kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuara nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljet e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.*”

4. Po ashtu, në bazë të nenit 16, parografi 4: “*Avokati i Popullit ka kompetencë që të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.*”

5. Për më tepër, bazuar në nenin 18, parografi 1.1, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: “*Të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit, dhe të angazhohet për eliminimin e tyre.*”; si dhe në pajtim me paragrafin 1.2: “*Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla.*”

III. RRETHANAT E RASTIT

6. Bazuar në informatat e pranuara në IAP, Avokati i Popullit ka hapur hetime (numri i rastit OIK 49/2021) lidhur me shkeljen e së drejtës së nënave (prindërve) vetushqyesë në Kosovë lidhur me njohjen e pushimit vjetor edhe për dy ditë pune për prindin vetushqyes, i cili i takon bazuar në Ligjin nr.03/L-212 të Punës i Republikës së Kosovës.

7. Avokati i Popullit ka monitoruar zbatimin e Ligjit nr.03/L-212 të Punës i Republikës së Kosovës dhe ka grumbulluar informata.

8. Më 26 shkurt 2021, Avokati i Popullit ka pranuar informatë nga Inspektorati i Punës se nuk kanë marrë asnje ankesë nga punëtorët për moszbatim të nenit 32 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës i Republikës së Kosovës.

IV. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 24 (Barazia para ligjit), përcakton:

- “Të gjithë janë të barabartë pa ra ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”
- “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tje ra, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”.
- “Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përpa rimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pa ba raba rtë. Masat e tillë do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë”.

Ndërsa nen 49 i Kushtetutës (E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit) përcakton:

- “E drejta e punës garanton. 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”
10. Ligji nr.03/L-212 i Punës i Republikës së Kosovës, në nenin 5 (Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit), përcakton:

- “Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, [...] trajnimin [...] kushtet e punësimit, [...] ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi”. [...] 3. “Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkizazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kerkohen për atë vend pune [...]”

Kurse nen 32 i po të njëjtit ligj përcakton:

“[...] Nënat me fëmijë deri në tri (3) vjeç si dhe prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor edhe për dy (2) ditë punë shtesë.”

V. ANALIZA LIGJORE

11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë ligjor, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të sundimit të ligjit edhe realizimi praktik i tyre. Kushtetuta shprehimisht e përcakton se është detyrë e të gjitha autoritetet e t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve, ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë.

12. Kushtetuta në mënyrë të veçantë garanton barazinë e të gjithë personave para Kushtetutës dhe ligjit, të drejtën e secilit për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim dhe ndalon çdo diskriminim në bazë të cilësdo bazë të listuar, por po ashtu shton edhe në bazë të ndonjë statusi tjetër personal që nuk përmendet në mënyrë të veçantë në këtë nen.

13. Në këtë drejtim, Institucioni i Avokatit të Popullit rikujton dispozitat juridike kushtetuese të Republikës së Kosovës, si në vijim:

[...]

“Neni 24 [Barazia para ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund tē diskriminohet nē bazë tē racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tē tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave tē nevojshme pér mbrojtjen dhe pérparimin e tē drejtave tē individëve dhe grupeve që janë nē pozitë tē pabarabartë. Masat e tillë do tē zbatohen derisa tē arrihet qëllimi pér tē cilin janë vënë ato.”
14. Avokati i Popullit thekson se sipas vendimeve tē Gjykatës Evropiane pér tē Drejtat e Njeriut (GjEDNj): “E drejta pér tē mos u diskriminuar shkeler kur punëdhënësit i trajtojnë njerëzit nē mënyrë tē pabarabartë [...] duke mos dhënë justifikim objektiv dhe tē arsyeshëm. Nē mënyrë që një justifikim i tillë tē jetë "objektiv dhe i arsyeshëm", duhet tē kalojë dy hapa: Së pari, duhet tē ekzistojë "qëllimi legitim" pér pabarazinë nē ffjalë dhe së dyti, duhet tē ekzistojë një "raport i arsyeshëm i proporcionaliteti midis mjeteve tē përdorura dhe objektivit që synohet tē arrihet.”
15. Avokati i Popullit thekson se diskriminimi nē fushën e punës është i ndaluar edhe me Ligjin e Punës, kurse me ligjin ombrellë pér mbrojtje nga diskriminimi është krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse pér mbrojtjen nga diskriminimi, me tē cilin ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë nē punësim nē çfarëdo baze, pér tē gjithë ata që i kanë shkelur, i shkelin ose mund t'i shkelin tē drejtat e çdo personi, nē veçanti kur kanë tē bëjnë me ligjin pér punë, duke përfshirë edhe tē drejtë pér pushim vjetor edhe pér dy ditë pune shtesë pér nënët vetushqyesë.

16. Ligji nr.03/L-212 i Punës

Në bazë tē nenit 32 tē Ligjit tē Punës është përcaktuar: “[...] Nënët me fëmijë deri nē tri (3) vjeç si dhe prindi vetushqyes dhe personat me aftësi tē kufizuara kanë tē drejtë nē pushim vjetor edhe pér dy (2) ditë punë shtesë.”

17. Avokati i Popullit vë nē pah se e drejta pér punë garantohet gjithashtu me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, tē cilat janë tē zbatueshme drejtpërdrejt nē Kosovë dhe kanë pérparësi mbi ligjet e Kosovës. Prandaj, detyrimi pér ta respektuar këtë tē drejtë kërkon shhangjen e masave që e pengojnë ose parandalojnë gëzimin e së drejtës pér pushim, e cila është pjesë e së drejtës së punës.

18. Ndërsa neni 14 (Ndalimi i diskriminimit) i Konventës Evropiane pér Drejtat e Njeriut përcakton:

“Gëzimi i tē drejtave dhe lirive tē përcaktuara nē këtë Konventë duhet tē sigurohet, pa asnjë dallim tē bazuar nē shkaqe tē tillë si gjinia, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatesia nē një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

VI. KONKLUZIONET E AVOKATIT TË POPULLIT

19. Avokati i Popullit konstaton se nē bazë tē nenit 32 tē Ligjit tē Punës, nënët me fëmijë deri nē tre vjeç, prindi vetushqyes dhe personat me aftësi tē kufizuara kanë tē drejtë nē pushim vjetor edhe pér dy ditë pune shtesë.

20. Avokati i Popullit konstaton se diskriminimi në fushën e punës është i ndaluar, përvèç tjerash, edhe me Ligjin e Punës dhe moszbatimin e këtij ligji në secilin nen, përfshirë nenin 32, e konsideron diskriminim.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të faktave të mbledhura, analizës së ligjeve vendore dhe Kushtetutës, konstaton se moszbatimi i nenit 32 të Ligjit të Punës nga ana e punëdhënësve është shkelje e Ligjit nr.03/L-212 të Punës, prandaj i

REKOMANDON

Inspektoratit të Punës:

- Ta monitorojoë zbatimin e nenit 32 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, i cili përcakton të drejtën për pushim edhe për dy ditë pune shtesë për nënrat me fëmijë deri në tre vjeç, për prindin vetushqyes dhe për personat me aftësi të kufizuara.

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale:

- Në legjislacion të japë definicion të saktë për prind vetushqyes.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor

Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit